



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. 2538 prot.

Tiranë, më 19.04.2021

Lënda: Njoftim me shpallje publike

Z. ARTAN XHAFA

Tiranë

Në zbatim të pikës 1, të nenit 56, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikës 17, gërma “b”, të Kreut II, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse ka nxjerrë aktin nr. 575/3 prot., datë 24.3.2021, të transferimit tuaj të përhershëm, në përfundim të pezullimit, në pozicionin Inspektor (Veteriner Kontrolli) në Zyrën Vendore të Veterinarisë, Vlorë, në Drejtorinë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë, kategoria IV-a.

Rezulton se, posta shqiptare, ka kthyer aktin e transferimit të nisur në adresën postare të vendosur në kërkesë nga vetë ju, me shënimin “I panjohur, në adresë familje tjetër”. Meqenëse njoftimi nuk është i mundur, si dhe çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur, në zbatim të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosëm të procedojmë me njoftimin publik me shpallje të aktit të transferimit të përhershëm, respektivisht në faqen e internetit të DAP-it, në një kënd të posaçëm pranë këtij institucioni, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë, si dhe në njësinë administrative ku rezulton vendbanimi juaj.

Sa më lart, afishojmë njoftimin publik me shpallje në këndin e institucionit të DAP-it, për një afat 10-ditor, nga data 19.04.2021, deri në datën 29.04.2021.



DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Koçiu